



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 630 Prot.

Tiranë, më 27/02/2026

PLANI I MONITORIMIT DHE MBIKËQYRJES SË TRANSPARENCËS PROAKTIVE PËR VITIN 2026

Në zbatim të Programit të Punës së Zyrës së Komisionerit për vitin 2026, në ushtrim të kompetencave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe referuar fushës së përgjegjësisë së Drejtorisë së Monitorimit të Programeve të Transparencës në Drejtorinë e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit, miratohet “Plani i Mbikëqyrjes së Transparencës Proaktive të Autoriteteve Publike” për vitin 2026 si më poshtë:

I. Qëllimi dhe objektivat e planit

Qëllimi i këtij plani është forcimi i transparencës proaktive të autoriteteve publike, përmes monitorimit sistematik, dhënies së rekomandimeve, ndjekjes së përmbushjes së tyre dhe, kur është e nevojshme, fillimit të procedurave të shqyrtimit administrativ.

Objektivat kryesore për vitin 2026 janë:

- rritja e nivelit të përmbushjes së detyrimeve ligjore për transparencën proaktive;
- përmirësimi i funksionalitetit të programeve institucionale të transparencës;
- rritja e publikimit dhe përditësimit të Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve;
- trajtimi me prioritet i autoriteteve me nivel të ulët transparence, bazuar në të dhëna objektive dhe indekse matëse.

II. Veprimtaritë kryesore të monitorimit dhe mbikëqyrjes

1. Hartimi i rekomandimeve për autoritetet publike të sektorit shëndetësor dhe ato të krijuara rishtazi:

Hartimi i rekomandimeve për autoritetet publike të sektorit shëndetësor, në lidhje me përmbushjen dhe zbatimin e detyrimeve ligjore si më poshtë:

- caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- vënien në zbatim, publikimin dhe përditësimin e programit institucional të transparencës;
- publikimin, afishimin dhe përditësimin e Regjistrisë të Kërkesave dhe Përgjigjeve.

Hartimi i rekomandimeve për autoritetet publike të krijuara rishtazi, me fokus:

- orientimin fillestar për përmbushjen e detyrimeve ligjore;
- ofrimin e modeleve standarde të programeve të transparencës;
- vendosjen e afateve të arsyeshme për përmbushje, përpara fillimit të procedurave administrative.

2. Fillimi i procedurave të shqyrtimit administrativ bazuar në rekomandimet e vitit 2025

Bazuar në të dhënat e Raportit lidhur me përmbushjen e detyrimeve të planit të monitorimit dhe mbikëqyrjes së transparencës proaktive për 2025, për autoritetet publike që:

- nuk i kanë përmbushur detyrimet e përcaktuara në rekomandimet e Komisionerit, ose
- i kanë përmbushur ato pjesërisht,

do të fillohen procedurat e shqyrtimit administrativ, sipas listës nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij plani.

3. Vazhdimi i procedurave të planifikuara dhe të papërfunduara në vitin 2025

Fillimi i procedurave të shqyrtimit administrativ për autoritetet publike për të cilat monitorimi ishte planifikuar gjatë vitit 2025, por nuk u realizua për arsye të mungesës së kapaciteteve apo kohës në dispozicion.

4. Monitorimi bazuar në Indekset e Transparencës Proaktive

Verifikimi i përmbushjes së detyrimeve ligjore bazuar në:

- Indeksin e Transparencës Proaktive të Autoriteteve Publike;
 - Indeksin e Transparencës Proaktive për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore,
- për vitin 2025, si dhe fillimi i procedurave të shqyrtimit administrativ për autoritetet e klasifikuara me “0–4.5 pikë”, të kategorizuara me nivel transparence proaktive minimale.

5. Monitorimi i vazhdueshëm i Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve

Verifikimi i përmbushjes së detyrimit për përditësimin e Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, bazuar në monitorim periodik për një periudhë 6-mujore radhazi, për të gjitha autoritetet publike. Në përfundim të periudhës monitoruese, do të nxirret një vlerësim/raport përmbledhës mbi gjendjen e regjistrave.

6. Procedura administrative të nisura kryesisht ose mbi bazë ankese

Shqyrtimet administrative mund të fillojnë kryesisht ndaj çdo autoriteti publik që ndodhet në kushtet e mungesës së transparencës sipas nenit 7 të ligjit nr. 119/2014, si dhe mbi bazë ankese, referuar shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 9/1 të këtij ligji.

III. Raportimi dhe publikimi

- Plani i monitorimit dhe mbikëqyrjes së transparencës proaktive për vitin 2026 publikohet në faqen zyrtare të Komisionerit.
- Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës ngarkohet me hartimin e raportit periodik gjashtëmujor, i cili do të pasqyrojë:
 - veprimtaritë e realizuara;
 - rekomandimet e dhëna;
 - procedurat administrative të nisura;
 - nivelin e përmirësimit të transparencës.

Bashkëlidhur miratohen listat e autoriteteve publike sipas pikave 1, 2, 3 dhe 4, pjesë përbërëse e këtij plani.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

Lista sipas pikës 1 të këtij plani

1. Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor
2. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
3. Instituti i Shëndetit Publik
4. Instituti i Integritetit të Ish të Përndjekurve Politikë
5. Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor
6. Klinika Stomatologjike Universitare
7. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut
8. Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore
9. Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
10. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror
11. Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët
12. Qendra e Shërbimit Mjekësor
13. Urdhri i Mjekëve
14. Urdhri i Farmacistëve
15. Urdhri i Stomatologut
16. Urdhi i Psikologut
17. Urdhri i Infermierit

Lista sipas pikës 2 të këtij plani

1. Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
2. Spitali Universitar i Traumës
3. Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”
4. Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”
5. Spitali Rajonal Vlorë
6. Spitali Rajonal Memorial Fier
7. Spitali Rajonal Korçë
8. Spitali Rajonal Gjirokastrë

Lista sipas pikës 3 të këtij plani

1. Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës
2. Avokatura e Shtetit
3. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.a
4. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.a
5. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan Sh.a
6. Bashkia Tropojë
7. Bashkia Maliq
8. Bashkia Gjirokastër
9. Bashkia Këlcyrë
10. Bashkia Libohovë
11. Bashkia Tepelenë
12. Bashkia Krujë

Lista sipas pikës 4 të këtij plani

1. Bashkia Fushë-Arrëz
2. Bashkia Dimal
3. Bashkia Kavajë
4. Bashkia Memaliaj
5. Rezidenca Studentore Universitare nr.1